

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Auditim
(zgjidhjet)

P6

Data 28/06/2025

Detyra 1

Yllësia ShA është një kompani e madhe e listuar në bursë që operon në sektorin e prodhimit, duke prodhuar pajisje të teknologjisë së lartë. Kompania ka një bord drejtorësh të përbërë nga pesë drejtorë ekzekutivë dhe dy drejtorë jo-ekzekutivë (DJE). Njëri nga drejtorët ekzekutiv ka përvojë në industrinë ushqimore si inxhinier i ushqimit, ndërsa tjetri ishte drejtor i një kompanie sigurimesh. Drejtori ekzekutiv shërben gjithashtu si kryetar i bordit. Kohët e fundit, aksionarët kanë ngritur shqetësime në lidhje me mungesën e transparencës së kompanisë në raportimin financiar dhe kontrollet e dobëta të brendshme, veçanërisht pasi u zbulua një mashtrim i rëndësishëm në departamentin e prokurimit. Mashtrimi përfshinte kontrata të fryra me furnizuesit, të cilat nuk u zbuluan për dy vjet. Furnizimet bëheshin nga zyrtari i blerjeve i cili ishte personi që grumbullonte ofertat dhe vet i miratonte ato.

Komiteti i auditimit, i kryesuar nga njëri prej DJE-ve, mbledhet rrallë dhe i mungojnë anëtarë me ekspertizë financiare të kohëve të fundit dhe relevante. Funkzioni i auditimit të brendshëm të kompanisë udhëhiqet nga menaxheri i auditimit të brendshëm dhe një staf i sapodiplomuar nga universiteti. Auditimi i brendshëm i raporton drejtpërdrejt te Drejtori Financiar, i cili ka heziturar të zbatojë rekomandimet nga raportet e kaluara të auditimit të brendshëm. Yllësia ShA gjithashtu nuk ka arritur të përmbushë disa kërkesa të kodit të qeverisjes korporative, të tilla si ato që lidhen me diversitetin e bordit dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të riskut.

Ju jeni menaxheri i auditimit në Green & Co, auditorët e jashtëm të Yllësia ShA. Gjatë planifikimit të auditimit të ardhshëm, ekipi juaj ka identifikuar dobësitë e qeverisjes korporative si një rrezik të rëndësishëm auditimi.

Kërkohet:

- a) Shpjegoni parimet kryesore të qeverisjes korporative që Yllësia ShA duket se i ka shkelur dhe diskutoni se si këto shkelje mund të ndikojnë në besueshmërinë e pasqyrave financiare të kompanisë. (8 pikë)
- b) Vlerësoni dobësitë specifike në strukturën e bordit dhe mjedisin e kontrollit të brendshëm të kompanisë Yllësia, dhe rekomandoni përmirësime për të adresuar këto dobësi. (8 pikë)
- c) Përshkruani përgjegjësitë e auditorit në vlerësimin e qeverisjes korporative gjatë auditimit të Yllësia ShA, duke përfshirë çdo procedurë specifike që do të kryeni për të adresuar rreziqet e identifikuar. (4 pikë)

Gjithsej: 20 pikë

Zgjidhja

a) Parimet Kryesore të Qeverisjes Korporative të Shkelura dhe Ndikimi në Pasqyrat Financiare

Udhëheqja dhe përbërja e bordit: Drejtori Ekzekutiv që vepron si kryetar shkel parimin e ndarjes së këtyre roleve për të siguruar mbikëqyrje të pavarur (p.sh., Kodit të Qeverisjes Korporative në Mbretërinë e Bashkuar). Kjo mund të çojë në vendimmarrje të pakontrolluar, duke rritur rrezikun e anashkalimit të kontrolleve nga menaxhmenti, gjë që mund të rezultojë në anomali materiale në pasqyrat financiare.

Diversiteti dhe efektiviteti i bordit: Mungesa e diversitetit të bordit dhe DJE-të e kufizuar (vetëm dy) sugjerojnë mungesë sfidimi të pavarur të vendimeve të bordit, duke lejuar potencialisht që të merren vendime të dobëta strategjike ose mashtrimet të mos zbulohen.

Llogaridhënia dhe transparencja: Mungesa e transparencës në raportimin financiar minon besimin e palëve të interesuara dhe mund të çojë në anomali të qëllimshme ose fshehje të çështjeve financiare.

Menaxhimi i rrezikut dhe kontrollet e brendshme: Kontrollet e dobëta të brendshme (p.sh., ndarja joadekuate e detyrave) lejuan që mashtrimi të vazhdonte, duke ndikuar drejtpërdrejt në besueshmërinë e balanceve të pasqyrave financiare, siç janë llogaritë e pagueshme dhe shpenzimet.

Efektiviteti i komitetit të auditimit: Mbledhjet e rralla dhe mungesa e ekspertizës financiare dobësojnë mbikëqyrjen e raportimit financiar, duke rritur rrezikun e gabimeve ose mashtrimit në pasqyrat financiare.

b) Dobësitë në strukturën e bordit dhe kontrollet e brendshme, me rekomandime:

Dobësia	Rekomandimi
Drejtori ekzekutiv si kryetar – Kombinon rolet udhëheqëse, duke zvogëluar pavarësinë e bordit.	Emëroni një DJE të pavarur si kryetar për të rritur mbikëqyrjen dhe për të sfiduar vendimet e menaxhmentit.
Drejtorë joekzekutiv të pamjaftueshëm dhe mungesë diversiteti – Vetëm dy drejtorë joekzekutiv dhe asnjëri nuk ka përvojën e industrisë apo atë financiare.	Rritja e numrit të drejtorëve joekzekutiv dhe sigurimi i ekspertizës së larmishme (p.sh., financiare, specifike për industrinë) për të forcuar efektivitetin e bordit.
Komitet joefektiv i auditimit – Takime të rralla dhe mungesë ekspertize financiare.	Emëroni një DJE me ekspertizë financiare të kohëve të fundit si kryetar dhe vendosni një orar takimesh të rregullta për të përmirësuar mbikëqyrjen e raportimit financiar dhe kontrolleve të brendshme.
Funksioni i dobët i auditimit të brendshëm – Pa staf të kualifikuar dhe i raporton drejtorit financiar, duke kompromentuar pavarësinë	Siguroni raportet e auditimit të brendshëm për komitetin e auditimit dhe ndani burime të mjaftueshme për të adresuar çështjet kritike
Kontrollet e dobta të brendshme – Ndarja joadekuate e detyrave çoi në mashtrim.	Zbatoni kontrolle të forta, të tilla si miratimi i pavarur i kontratave të furnizuesve dhe rishikimet e rregullta të kontrollit.

c) Përgjegjësitë dhe procedurat e auditorit:

- Përgjegjësia : Auditorët duhet të vlerësojnë qeverisjen korporative si pjesë e procesit të vlerësimit të rrezikut (SNA 315) për të identifikuar rreziqet e anomalive materiale për shkak të qeverisjes së dobët ose kontrolleve të brendshme.
- Procedurat :
 - Rishikimi i procesverbaleve të bordit dhe komitetit të auditimit për të vlerësuar efektivitetin e praktikave të qeverisjes dhe vendimmarrjes.
 - Vlerësoni pavarësinë dhe kompetencën e DJE-ve dhe komitetit të auditimit përmes intervistave dhe shqyrtimit të kualifikimeve.
 - Testoni kontrollet e brendshme, veçanërisht në prokurim, për të vlerësuar shkallën e ndarjes së detyrave dhe rrezikun e mashtrimit.
 - Diskutoni dobësitë e qeverisjes me menaxhmentin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, duke raportuar mangësitë e rëndësishme në letrën e menaxhmentit.

Detyra 2

Teknikus SHA është një kompani e-commerce (tregtisë elektronike) me rritje të shpejtë e specializuar në elektronikën e konsumit të përgjithshëm, me të ardhura vjetore prej 150 milionë €. Firmës suaj, Zenitium Audit, i është kërkuar të marrë përsipër detyrën e auditorit ligjor për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024, pas dorëheqjes së auditorit të mëparshëm për shkak të mosmarrëveshjeve me menaxhmentin mbi zbatimin e SNRF 15 për njohjen e të ardhurave. Modeli i të ardhurave të Teknikus është kompleks, duke përfshirë shitjet online, shërbimet e abonimit dhe komisionet nga shitësit e palëve të treta të vendosura në platformën e saj. Kompania operon në pesë juridiksione, duke ngritur shqetësime në lidhje me pajtueshmërinë me rregulloret e ndryshme tatimore. Pasqyrat financiare tregojnë një rritje prej 30% të të ardhurave, të cilën menaxhmenti ia atribuon ofertave të reja të abonimit. Partneri i auditimit ju ka ngarkuar me vlerësimin e angazhimit dhe planifikimin e auditimit.

Kërkohet:

(a) Përshkruani pesë procedura që do të kryeni si pjesë e procesit të pranimin të angazhimit.

(10 pikë)

(b) Shpjegoni katër faktorë që duhen marrë në konsideratë gjatë planifikimit të auditimit të Teknikus SHA.

(8 pikë)

(c) Diskutoni rëndësinë e të kuptuarit të biznesit të klientit në këtë kontekst. (2 pikë)

Gjithsej: 20 pikë

Zgjidhja

(a) Procedurat e Pranimit të Angazhimit

1. Vlerësimi i integritetit të menaxhmentit: Kontaktoni auditorin e mëparshëm, me pëlqimin e Teknikus, për të kuptuar arsyet e dorëheqjes së tij, duke u përqendruar në mosmarrëveshjen për IFRS 15. Rishikoni letrat ose korrespondencën e autorizimit profesional për të vlerësuar nëse menaxhmenti ka ushtruar presion mbi auditorin për të pranuar praktika të papërshtatshme të kontabilitetit, të cilat mund të tregojnë mungesë integriteti dhe të paraqesin një kërcënim për pavarësinë e auditorit.
2. Vlerësimi i kompetencës dhe burimeve të firmës: Konfirmoni aftësinë e Zenitium Audit për të audituar një biznes të tregtisë elektronike prej 150 milionë € me rrjedha komplekse të ardhurash dhe operacione shumë-juridiksionale. Sigurohuni që stafi të jetë i trajnuar në SNRF 15, pajtueshmërinë ndërkombëtare tatimore dhe auditimin e tregtisë elektronike, dhe verifikoni disponueshmërinë e orëve të mjaftueshme të auditimit.
3. Kryeni kontrollin e duhur të klientit: Kryeni verifikime të të dhënave mbi menaxhmentin kryesor dhe pronarët përfitues të Teknikus për të identifikuar rreziqet e pastrimit të parave ose mashtrimit, duke pasur parasysh operacionet në pesë juridiksione. Përdorni të dhënat publike, dosjet rregullatore dhe kërkimet negative në media për të përmbushur rregulloret kundër pastrimit të parave.
4. Hartoni letrën e angazhimit: Hartoni një letër angazhimi të nënshkruar që përshkruan fushëveprimin e auditimit, përgjegjësitë e menaxhmentit dhe auditorëve, si dhe pajtueshmërinë me SNA-të. Përfshini rreziqe specifike, të tilla si njohja e të ardhurave sipas SNRF 15 dhe pajtueshmëria tatimore, dhe konfirmoni qasjen në të dhënat ndërkombëtare.
5. Rishikimi i punës së auditorit paraardhës: Nëse lejohet, shqyrtoni dokumentet e punës së auditorit të mëparshëm për të identifikuar çështjet e pazgjidhura, veçanërisht mosmarrëveshjet për njohjen e të ardhurave. Përqendrohuni në rregullimet e auditimit, deklaratat e menaxhmentit dhe kufizimet e fushëveprimit për të informuar vlerësimin e rrezikut të vitit aktual.

(b) Faktorët e Planifikimit të Auditimit

1. Mjedisi i biznesit: Analizoni presionet konkurruese të industrisë së tregtisë elektronike, të tilla si rritja e shpejtë dhe avancimet teknologjike, të cilat mund të nxisin mbivlerësimin e të ardhurave për të tërhequr investitorët. Vlerësoni kushtet ekonomike në pesë juridiksione që ndikojnë në kërkesën e klientëve dhe rreziqet e pajtueshmërisë tatimore.
2. Kompleksiteti i njohjes së të ardhurave: Ndani burime shtesë për të testuar të ardhurat nga shitjet online, abonimet dhe komisionet e shitësve, pasi SNRF 15 kërkon identifikimin e detyrimeve të performancës, gjë që përfshin gjykim të rëndësishëm, veçanërisht për abonimet shumëvjeçare.
3. Rreziqet juridiksionale: Planifikoni rreziqet e mosrespektimit të ligjeve tatimore në secilin juridiksion, pasi gjobat mund të ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare. Angazhoni specialistë të taksave ose ekipe lokale të auditimit për të adresuar kërkesat specifike rregullatore.
4. Transaksionet me palët e lidhura: Hetoni transaksionet e mundshme të pashpalosura të palëve të lidhura me shitësit e palëve të treta, të cilat mund të përdoren për të manipuluar të ardhurat ose shpenzimet. Planifikoni procedurat për të shqyrtuar kontratat e shitësve dhe zbulimet e menaxhmentit.

(c) Rëndësia e të kuptuarit të biznesit të klientit

Të kuptuarit e biznesit të Teknikus është thelbësore për të identifikuar rreziqet e anomalive materiale specifike për operacionet e saj të tregtisë elektronike dhe praninë ndërkombëtare. Njohja e modelit të saj të të ardhurave, trendet e industrisë dhe mjedisi rregullator siguron procedura të synuara të auditimit për fusha me rrezik të lartë si përputhshmëria me IFRS 15 dhe detyrimet tatimore.

Detyra 3

Logjistika ShPK, një kompani logjistike me 80 milionë € të ardhura, është klienti juaj i auditimit. Gjatë auditimit, ju identifikuat një anomali materiale prej 3 milionë € në vlerësimin e stoqeve për shkak të stokut të vjetëruar që nuk është shlyer, pasi menaxhmenti pret një rimëkëmbje të tregut. Përveç kësaj, kompania nuk arriti të shpalos një detyrim kontingjent prej 5 milionë € në lidhje me një padi në pritje, të cilën ju e konsideroni materiale për shkak të ndikimit të saj të mundshëm në likuiditet. Menaxhmenti ka refuzuar të rregullojë stoqet ose të shpalos detyrimin, duke përmendur arsye strategjike. Partneri i auditimit ju ka kërkuar të përgatiteni për finalizimin e raportit të auditimit.

Kërkohet:

- (a) Shpjegoni llojet e opinionëve të auditimit që mund të jenë të përshtatshme në këtë skenar. (8 pikë)
- (b) Përshkruani katër procedura që duhen kryer para lëshimit të raportit të auditimit. (8 pikë)
- (c) Diskutoni rëndësinë e komunikimit me personat ngarkuar me qeverisjen përpara finalizimit të raportit. (4 pikë)

Gjithsej: 20 pikë

Zgjidhja

(a) Opinionet e auditimit

- **Opinion i kualifikuar:** Nëse anomalia e stoqeve prej 3 milionë € është materiale, por jo i përhapur (p.sh., 3.75% e të ardhurave, nën një prag prej 5%), një opinion i kualifikuar mund të deklarojë se pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë, përveç vlerësimit të stoqeve. Baza për kualifikim do të detajonte dështimin për të zhvlerësuar stokun e vjetëruar sipas SNK 2.
- **Opinion i kundërt:** Nëse anomalia prej 3 milionë € dhe detyrimi i pashpalosur prej 5 milionë € janë materiale dhe të përhapura (p.sh., ndikimi i kombinuar tejkalon 10% të aseteve), një opinion i kundërt mund të tregojë se pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë për shkak të anomalive të konsiderueshme që ndikojnë në elementë të shumtë të pasqyrave financiare.
- **Paragrafi i theksimit të çështjes:** Nëse menaxhmenti shpalos detyrimin kontingjent pas diskutimeve, por refuzon të rregullojë stoqet, një opinion i kualifikuar për stoqet mund të përfshijë një paragraf të theksimit të çështjes për të nxjerrë në pah rëndësinë e padisë pa e modifikuar më tej opinionin.
- **Mohim Opinioni:** Nëse auditori nuk mund të marrë dëshmi të mjaftueshme në lidhje me rezultatin e padisë (p.sh., qasje e kufizuar në opinione ligjore) dhe ndikimi i saj është i përhapur, mund të lëshohet një mohim opinionin, duke përmendur kufizimin e fushëveprimit së bashku me çështjen e stoqeve.

(b) Procedurat para lëshimit të raportit

- **Diskutimi me menaxhmentin:** Takohuni me menaxhmentin e kompanisë për të konfirmuar refuzimin e tyre për të rregulluar stoqet prej 3 milionë € ose për të shpalosur detyrimin prej 5 milionë €. Dokumentoni arsyetimin e tyre (p.sh., pritjet e rimëkëmbjes së tregut) dhe shpjegoni ndikimin në opinionin e auditimit, duke inkurajuar rregullimet për të shmangur një opinion të modifikuar.
- **Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen:** Paraqitni gjetjet para komitetit të auditimit, duke detajuar anonalinë dhe mosshpalosjen, materialitetin e tyre (p.sh., 3 milionë € tejkalojnë 1% të të ardhurave) dhe opinionin e propozuar. Jepni prova si raportet e moshimit të stoqeve dhe korrespondencën ligjore për të mbështetur përfundimet.
- **Rishikimi i Efektit Kumulativ:** Shqyrtoni pasqyrat financiare për anomali të tjera, duke vlerësuar nëse efekti i kombinuar i çështjeve prej 3 milionë dhe 5 milionë €, plus çdo çështje tjetër, është i përhapur. Për shembull, rillogaritni pragjet e materialitetit (p.sh., 1% e të ardhurave = 0.8 milionë €) për të vlerësuar ndikimin.
- **Dokumentimi i Vendimit :** Regjistroni dëshmitë e auditimit, përgjigjet e menaxhmentit dhe arsyetimin për opinionin në dokumentet e punës. Përfshini llogaritjet (p.sh., ndikimi i zhvlerësimit të stoqeve) dhe komunikimet me qeverisjen për të justifikuar përfundimet e raportit të auditimit.

(c) Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen

Sipas ISNA 260, komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen është thelbësor për të diskutuar anonalinë prej 3 milionë € dhe mosshpalosjen prej 5 milionë €, duke siguruar transparencë në lidhje me ndikimin e tyre në pasqyrat financiare. Kjo i lejon komitetit të auditimit të kundërshtojë refuzimin e menaxhmentit, duke çuar potencialisht në rregullime. Komunikimi

duhet të përfshijë dëshmi, vlerësime të materialitetit dhe opinionin e propozuar, duke nxitur mbikëqyrje efektive dhe besim në procesin e auditimit.

Detyra 4

Oqeani ShA, një kompani transporti detar me 150 milionë € në asete dhe 100 milionë € në të ardhura, është klienti juaj i auditimit. Në vitin 2024, kompania raportoi një humbje operative prej 10 milionë € për shkak të një rritjeje prej 25% të kostove të karburantit dhe një rënie prej 20% të kërkesës për mallra të shkaktuar nga ndërprerjet e tregtisë globale. Oqeani ShA ka një kredi prej 20 milionë € që duhet të paguhet në qershor 2025, të siguruar me flotën e saj të anijeve, por banka ka treguar kushte më të rrepta rifinancimi për shkak të performancës financiare të kompanisë. Menaxhmenti po negocion një marrëveshje rifinancimi dhe po eksploron masa për uljen e kostove, duke përfshirë shkurtimet e vendeve të punës dhe zvogëlimin e flotës, por nuk ka marrëveshje të finalizuara. Pasqyrat financiare përgatiten në bazë të hipotezës së vijimësisë, me një shënim që zbulon humbjen, kredinë dhe rënien e kërkesës, por i mungojnë detaje mbi perspektivat e rifinancimit. Rezervat e parave të gatshme të kompanisë janë 5 milionë € dhe ajo përballet me 8 milionë € në pagesa furnizuesish që duhen paguar brenda tre muajve. Partneri i auditimit është i shqetësuar për aftësinë e Oqeani ShA për të vazhduar si një biznes në vijimësi.

Kërkohet:

- (a) Shpjegoni katër faktorë që mund të hedhin dyshime mbi aftësinë e Oqeani ShA për të vazhduar si një biznes në vijimësi, duke iu referuar ISA 570. (8 pikë)
- (b) Përshkruani pesë procedura auditimi për të vlerësuar supozimin e vijimësisë së biznesit. (10 pikë)
- (c) Diskutoni ndikimin në raportin e auditimit nëse pasiguritë lidhur me vijimësinë nuk shpalosen në mënyrë të mjaftueshme. (2 pikë)

Gjithsej: 20 pikë

Zgjidhja

(a) Faktorët e hipotezës së vijimësisë

1. Humbje e rëndësishme operative: Humbja prej 10 milionë € (10% e të ardhurave) sinjalizon vështirësi financiare, duke zvogëluar rrjedhat e parasë dhe duke kufizuar aftësinë e Oqeani ShA për të përmbushur detyrimet e vazhdueshme, të tilla si 8 milionë € në pagesat e furnitorëve.
2. Maturimi i afërt i kredisë: Kredia prej 20 milionë € që duhet paguar në qershor 2025, e kombinuar me perspektivat e pasigurta të rifinancimit, paraqet një rrezik likuiditeti, pasi dështimi i rifinancimit mund të detyrojë shitjen e aseteve ose falimentimin.
3. Rënia e kërkesës për ngarkesa: Rënia e kërkesës prej 20% zvogëlon rrjedhat e të ardhurave, duke përkeqësuar vështirësitë financiare dhe duke kërcënuar qëndrueshmërinë operacionale të kompanisë gjatë 12 muajve të ardhshëm.
4. Rezerva të ulëta në para të gatshme: Me vetëm 5 milionë € në para të gatshme kundrejt 8 milionë € në pagesa të menjëhershme nga furnizuesit dhe një detyrimi kredie prej 20 milionë €, Oqeani ShA përballlet me një mungesë të konsiderueshme likuiditeti, duke hedhur dyshime mbi hipotezën e vijimësisë.

(b) Procedurat e Auditimit

1. Vlerësoni parashikimet e rrjedhës së parasë: Merrni parashikimet 12-mujore të menaxhmentit për rrjedhën e parasë, duke shqyrtuar supozimet në lidhje me kostot e karburantit, rimëkëmbjen e kërkesës dhe suksesin e rifinancimit. Krahasojini me performancën historike dhe trendet e industrisë për të vlerësuar arsyeshmërinë.
2. Rishikoni dokumentacionin e kredisë: Inspektoni marrëveshjen e kredisë prej 20 milionë € dhe korrespondencën e fundit bankare për të konfirmuar kushtet e ripagimit, marrëveshjet dhe negociatat e rifinancimit, duke vlerësuar mundësinë e sigurimit të financimit të ri.
3. Analizoni gjendjen financiare: Llogaritni koeficientët e likuiditetit (p.sh., koeficienti qarkullues = 5 milionë € para në dorë / 28 milionë € detyrime afatshkurtra) dhe koeficientët e aftësisë paguese, duke i krahasuar me normat e industrisë së transportit detar për të vlerësuar stabilitetin financiar.
4. Bëni pyetje rreth planeve të shmangies/zvogëlimit të vështirësisë financiare: Diskutoni strategjitë e menaxhimit për uljen e kostove (p.sh., pushimet nga puna, zvogëlimi i flotës) me drejtorin financiar, duke vlerësuar fizibilitetin, afatin kohor dhe ndikimin e tyre në rrjedhat e parave të gatshme përmes planeve ose buxheteve të detajuara.
5. Merrni përfaqësimet me shkrim: Kërkoni një letër përfaqësimi nga menaxhmenti që konfirmon se baza e hipotezës së vijimësisë është e përshtatshme dhe se të gjitha pasiguritë materiale, duke përfshirë çështjet e kredisë dhe kërkesës, janë shpalosur.

(c) Ndikimi në Raportin e Auditimit

Shpalosja e pamjaftueshme me pasigurisë materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë (p.sh., rreziqet e rifinancimit për kredinë prej 20 milionë €) mund të rezultojë në një opinion të kualifikuar osjetë kundërt (ISA 705), pasi humbja prej 10 milionë € dhe detyrimet e pagesës prej 8 milionë € janë materiale (10% dhe 8% e të ardhurave). Sipas ISA 570, një pasiguri materiale kërkon shpalosje të qartë, dhe mosshpalosja mund t'i mashtrojë përdoruesit e pasqyrave financiare.

Detyra 5

Fudi ShA është një kompani e përpunimit të ushqimit e listuar në bursë me seli në Mbretërinë e Bashkuar, e cila gjeneron 90 milionë € të ardhura vjetore përmes prodhimit dhe shitjes së mallrave organike të paketuara, siç janë drithërat, ushqimet e lehta dhe produktet me bazë bimore. Kompania operon në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut, me një zinxhir furnizimi që përfshin shumë vende. Produktet e saj tregtohen si produkte organike me burim të qëndrueshëm dhe të certifikuar, duke u bërë tërheqëse konsumatorëve të ndërgjegjshëm për shëndetin. Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024, firma juaj, Fiona Audit, është emëruar si auditor i jashtëm për të audituar pasqyrat financiare të Fudi ShA.

Gjatë fazës së planifikimit të auditimit, ju keni mbledhur informacionin e mëposhtëm:

Për të përmirësuar efikasitetin dhe ndjekjen e kostove, Fudi ShA investoi 12 milionë € në një sistem të ri të automatizuar prodhimi të projektuar për të monitoruar kostot e lëndëve të para, të cilat arrijnë në 30 milionë € (33% të të ardhurave) në koston e shitjeve. Sistemi, i zhvilluar dhe zbatuar nga një shitës i palës së tretë, u lançua gjashtë muaj më parë me mbikëqyrje minimale nga menaxhmenti i Fudi ShA. Testimi fillestar nga departamenti i IT zbuloi gabime në migrimin e të dhënave, duke rezultuar në mospërputhje në të dhënat e stokeve, veçanërisht për lëndët e para që prishen. Sistemit gjithashtu i mungojnë kontrole të forta të qasjes, duke ngritur shqetësime në lidhje me ndryshime të paautorizuara në të dhënat e kostos.

Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA) po heton Fudi ShA për shkelje të mundshme në rregulloret e etiketimit, duke pretenduar se disa produkte janë etiketuar gabimisht si "100% organike" kur ato përmbanin aditivë jo-organikë. Hetimi mund të çojë në gjoba deri në 5 milionë €, tërheqje produktesh dhe dëme të konsiderueshme të reputacionit. Menaxhmenti nuk ka regjistruar ende një provizion për gjoba të mundshme, duke përmendur pasiguri në lidhje me rezultatin, por ka përfshirë shpalosje të kufizuara në pasqyrat financiare.

Drejtori financiar, nën presion të fortë nga bordi për të siguruar një kredi bankare prej 15 milionë € për të financuar zgjerimin në tregje të reja, ka vendosur objektiva agresive fitimi për vitin 2024. Marrëveshja e kredisë kërkon që Fudi ShA të mbajë koeficient specifik financiar, duke përfshirë një marzh minimal fitimi. Ekzistojnë shqetësime se menaxhmenti mund të manipulojë njohjen e të ardhurave ose të nënvlerësojë shpenzimet për të përmbushur këto objektiva, veçanërisht duke pasur parasysh historinë e bordit të lidhjes së bonuseve ekzekutive me performancën e fitimit.

Klienti më i madh i Fudi ShA, një shitës me pakicë i madh në Amerikën e Veriut që përbën 15% të të ardhurave (13.5 milionë €), ka vonuar pagesat për shkak të ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit të shkaktuara nga mbingarkesa në port dhe mungesa e fuqisë punëtore. Bilanci i arkëtueshëm i papaguar për këtë klient është 4 milionë €, me moshë mbi 90 ditë. Menaxhmenti nuk ka njohur një provizion për borxhet e dyshimta, duke pohuar se klienti do ta shlyejë bilancin së shpejti, pavarësisht lajmeve të fundit për vështirësitë financiare të shitësit me pakicë.

Gjatë fazës së planifikimit, zbuloni se Fudi ka hyrë në disa transaksione të rëndësishme me GreenGO, një furnizues i lëndëve të para organike. GreenGO është në pronësi të vëllait të kryeshefit ekzekutiv dhe këto transaksione, që arrijnë në 8 milionë € në blerje gjatë vitit 2024, nuk u shpalosën si transaksione me palët e lidhura në pasqyrat financiare. Ka dokumentacion të kufizuar për të mbështetur çmimin e këtyre transaksioneve, duke ngritur shqetësime në lidhje me substancën tregtare të këtyre transaksioneve.

Kërkohet:

- a) Identifikoni dhe shpjegoni pesë rreziqe të auditimit (rreziqet e anomalive materiale) në pasqyrat financiare të Fudi ShA. (10 pikë)
- b) Përshkruani katër procedura specifike të auditimit për të adresuar rreziqet e auditimit të identifikuar në pjesën (a). (8 pikë)
- c) Shpjegoni rëndësinë e skepticizmit profesional në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare të kompanisë Fudi (2 pikë)

Gjithsej: 20 pikë

Zgjidhja

a) Rreziqet e auditimit

- Rreziku i anomalisë në vlerësimin e stoqeve

Gabimet e migrimit të të dhënave në sistemin e ri të prodhimit rrisin rrezikun e të dhënave të pasakta të stoqeve, veçanërisht për lëndët e para që prishen. Kjo mund të çojë në stoqe të mbivlerësuara dhe kosto të nënvlerësuar të shitjeve, duke deklaruar gabimisht fitimin (rrezik i vetëvetishëm dhe i kontrollit). SNA 315 kërkon që auditorët të identifikojnë rreziqet që rrjedhin nga mangësitë e sistemit të IT-së.

- Rreziku i provizionit të pamjaftueshëm për gjobat rregullatore

Mosregjistrimi nga ana e menaxhmentit i një provizionit për gjobat e mundshme të EFSA-s, pavarësisht hetimit në vazhdim, mund të nënvlerësojë detyrimet dhe shpenzimet nëse rezultati është i mundshëm dhe i parashikueshëm. Kjo rrezikon anamali materiale në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e të ardhurave (rrezik i vetëvetishëm). SNA 450 trajton vlerësimin e anomalive, duke përfshirë ato nga provizionet e lëna jashtë.

- Rreziku i manipulimit të të ardhurave ose shpenzimeve

Presioni i drejtorit financiar për të përmbushur objektivat agresive të fitimit për kredinë bankare rrit rrezikun e raportimit financiar mashtrues, siç është njohja e parakohshme e të ardhurave ose nënvlerësimi i shpenzimeve. SNA 240 thekson anashkalimin e kontrolleve nga menaxhmenti si një rrezik të rëndësishëm mashtrimi.

- Rreziku i të arkëtueshmeve të mbivlerësuara

Të arkëtueshmet e papaguara prej 4 milionë € nga klienti më i madh, së bashku me refuzimin e menaxhmentit për të njohur një shpenzim për borxhet e dyshimta, mund të mbivlerësojnë të arkëtueshmet tregtare dhe fitimin nëse klienti nuk mund të paguajë. Ky është një rrezik i vetvetishëm për shkak të faktorëve të jashtëm ekonomikë dhe një rrezik kontrolli nëse proceset e kontrollit të shitjeve me kredi janë të dobëta.

- Rreziku i transaksioneve të palëve të lidhura

Blerjet prej 8 milionë euro nga GreenGO, në pronësi të vëllait të KE, nuk u shpalosën si transaksione me palët e lidhura. Mungesa e dokumentacionit dhe potenciali për vendosjen e çmimeve të paarritshme rrit rrezikun e anomalisë në shpenzime, pasuri ose detyrime dhe mospërputhjes me kërkesat e shpalosjes së informacioneve shpjeguese sipas SNK 24. SNK 550 thekson nevojën për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet që lidhen me transaksionet e palëve të lidhura.

b) Katër procedura specifike të auditimit

1. Vlerësimi i stoqeve: Kryeni numërime fizike të stoqeve dhe përputhni ato me të dhënat e sistemit për të identifikuar mospërputhjet nga gabimet e migrimit të të dhënave. Testoni vlerësimin e lëndëve të para duke i krahasuar me faturat e fundit të furnizuesit dhe duke i vlerësuar për vjetërim.
2. Gjobat rregullatore: Rishikoni korrespondencën me EFSA-n dhe opinionet e këshilltarëve ligjorë për të vlerësuar gjasat dhe madhësinë e gjobave. Vlerësoni mjaftueshmërinë e shpalosjeve dhe testoni nëse një provizion duhet të njihet sipas SNK 37.
3. Testimi i të ardhurave dhe shpenzimeve: Zgjidhni një mostër të transaksioneve të të ardhurave pranë fundit të vitit për të verifikuar kriteret e prerjes dhe të njohjes sipas SNRF

15. Kryeni procedura analitike në llogaritë e shpenzimeve për të identifikuar trendet e pazakonta që mund të tregojnë manipulim.

4. Transaksionet me palët e lidhura: merrni një listë nga menaxhmenti të palëve të lidhura dhe verifikoni plotësinë duke rishikuar procesverbalet e takimit të bordit dhe aksionarëve. Testoni blerjet prej 8 milion Euro nga GreenGO duke krahasuar çmimet e tregut dhe duke vlerësuar dokumentacionin për substancën tregtare, duke siguruar pajtueshmëri me kërkesat për shpalosje sipas SNK 24.

c) Rëndësia e skepticizmit profesional

Skepticizmi profesional është kritik në vënien në pikëpyetje të pohimeve të menaxhmentit, duke pasur parasysh presionin për të përmbushur objektivat e fitimit dhe strukturën e dobët të qeverisjes. Ai siguron që auditorët të sfidojnë mungesën e provizioneve, të arkëtueshmet e vonuara dhe gabimet e sistemit, duke zvogëluar rrezikun e pranimin të pasqyrave financiare që përmbajnë anomali.